



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Nr. 11 /2026
Datë: 30/01 /2026

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në nenin 31 të Rregullores (QRK) - Nr.17/2024 së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 11 (paragrafi 3) të Rregullores QRK-Nr. 01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M


1. Shfuqizohet Vendimi Nr. 98/2025, i datës 03.07.2025 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.11/2024, të datës 29.01.2024, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr.91/2025, të datës 20.06.2025.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Anita KALANDERI

Sekretare e Përgjithshme

Vendimi i'u dërgohet:

- Anëtarëve të grupit punues;
- Kabinetit të Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Nr. 98 /2025
Datë: 03/07/2025

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në nenin 31 të Rregullores (QRK) - Nr.17/2024 së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 11 (paragrafi 3) të Rregullores QRK-Nr. 01/2020 për standardet e organizimit të brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës dhe bashkëpunimin në institucionet e administratës shtetërore dhe agjencitë e pavarura, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 11/2024, të datës 29.01.2024, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr. 91/2025 të datës 20.06.2025


1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 2.1 dhe 2.2. si dhe shtohet pika 2.15. e vendimit Nr. 11/2024, të datës 29.01.2024 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin nr. 91/2025 të datës 20.06.2025, si në vijim:

2.1. Lulzim Beqiri DL/MD, Kryesues;

2.2. Blerim Shabani DPSHSF/MD, zv. Kryesues;


2.15. Anita Koci DL/MD.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Anita KALANDERI

Sekretare e Përgjithshme

Vendimi i'u dërgohet:

- Anëtarëve të grupit punues;
- Kabinetit të Ministres në detyrë të Drejtësisë;
- Zyres së Sekretares së Përgjithshme/MD;
- Departamentit për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the General Secretary

Nr. 11 /2024
Datë: 29.01 /2024

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 3) të Rregullores QRK-Nr.01/2020 për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin në Institucionet e Administratës Shtetërore, si dhe në nenin 9 (paragrafi 5) të Rregullores Nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Grupi Punues për hartimin dhe finalizimin e projekt akteve nënligjore që derivojnë nga Ligji Nr. 08/L-255 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, si në vijim:

- 1.1. Projekt Udhëzim Administrativ për shërbimet e integruara;
- 1.2. Projekt Udhëzim Administrativ për procedurën e caktimit të kujdestarisë, llojet e kujdestarisë dhe çështjeve të tjera lidhur me kujdestarinë;
- 1.3. Projekt Rregullore për organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e panelit për strehim familjar;
- 1.4. Projekt Udhëzim Administrativ për shërbimet e strehimit llojet e strehimit, llojet dhe numrin e përfituesve të vendosur, dhe çështjet tjera lidhur me strehim;
- 1.5. Projekt Rregullore për organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e panelit për strehim rezidencial;
- 1.6. Projekt Udhëzim Administrativ për kushtet për ofrimin e strehimit rezidencial, llojet e strehimit, kushtet për kryerjen e strehimit, llojet dhe numrin e përfituesve të vendosur;
- 1.7. Projekt Rregullore për organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e panelit për adoptim;
- 1.8. Projekt Udhëzim Administrativ për procedurat për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në procesin e adoptimit;
- 1.9. Projekt Udhëzim Administrativ për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në procesin e mbështetjes së jetesës së pavarur dhe të mbikëqyrur dhe aftësimin për jetën dhe punën e pavarur;
- 1.10. Projekt Udhëzim Administrativ për kriteret dhe mënyrën e licencimit të profesionistëve individual që ofrojnë shërbime sociale;
- 1.11. Projekt Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Profesional për Shërbime Sociale dhe Familjare;
- 1.12. Projekt Udhëzim Administrativ për kushtet minimale për themelimin e institucioneve të shërbimeve sociale;

- 1.13. Projekt Udhëzim Administrativ për organizimin, përgjegjësitë, llojin dhe numrin e profesionistëve si dhe funksionimi i qendrës për punë sociale;
- 1.14. Projekt Rregullore për organizimin dhe fushëveprimin e qendrave për kujdes ditor;
- 1.15. Projekt Rregullore për organizimin dhe fushëveprimin e qendrave për pranim;
- 1.16. Projekt Udhëzim Administrativ për shërbimet sociale dhe familjare nga vullnetarët;
- 1.17. Projekt Udhëzim Administrativ për procedurën për dhënien, përsëritjen, pezullimin dhe marrjen e licencës;
- 1.18. Projekt Udhëzim Administrativ për kriteret dhe kushtet për marrjen e licencës për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga punonjësit profesional;
- 1.19. Projekt Udhëzim Administrativ për mënyrën e inspektimit të ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare;
- 1.20. Projekt Udhëzim Administrativ për procedurën, kushtet dhe parimet e zbatimit të partneritetit publiko-privat në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare;
- 1.21. Projekt Udhëzim Administrativ për mbajtjen e evidencës unike dhe të dokumentacionit të përfituesve të të drejtave, formës, masave dhe shërbimeve nga përkujdesit social dhe familjar;
- 1.22. Projekt Udhëzim Administrativ për përmbajtjen e licencës.

2. Grupi punues nga pika 1 e këtij vendimi, emërohet në këtë përbërje:

- 2.1. Feride Podvorica, DL/MD, Kryesuese;
- 2.2. Ruzhdi Osmani, DPSHSF/MD, Zv. Kryesues;
- 2.3. Alberita Hyseni, ZL/ZKM, anëtare;
- 2.4. Ardian Mehmeti, DL/MD, anëtar;
- 2.5. Adile Shaqiri DPSHSF/MD, anëtare;
- 2.6. Ganimete Murseli, DPSHSF/MD, anëtare;
- 2.7. Skender Jahaj, DPSHSF/MD, anëtar;
- 2.8. Fitore Rexhaj, DPSHSF/MD, anëtare;
- 2.9. Diellza Mujaj, DL/MD, anëtare;
- 2.10. Nexhat Sylja, DBF/MD, anëtar;
- 2.11. Gëzim Bislimi, DB/MFPT, anëtar;
- 2.12. Përfaqësues nga MAPL, anëtar;
- 2.13. Blerim Shabani, Asociacioni i Qendrave për Punë Sociale, anëtar;
- 2.14. Përfaqësues nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, anëtar/e.

3. Pjesë e Grupit Punues ftohet edhe përfaqësuesi/sja nga:

- 3.1. KOMF -it;
- 3.2. Terre Des Homes;
- 3.3. Save the Children;
- 3.4. UNICEF;
- 3.5. OFAP; dhe
- 3.6. Sos Fshatrat.

4. Gjatë hartimit të akteve nënligjore, Grupi Punues duhet t'i përmbahet rregullave dhe procedurave të parashikuara në Rregulloren nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Kosovës dhe legjislacionit përkatës në fuqi për hartimin e legjislacionit.

5. Sipas nevojave të Grupit Punues për realizimin e obligimeve të parapara me këtë vendim, Kryesuesi i Grupit Punues mund të ftojë edhe përfaqësues të tjerë nga institucionet publike dhe shoqëria civile.

6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Anita KALANDERI

Sekretarë e Përgjithshme



Vendimi i'u dërgohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.